

**NDAJSHTESIMI SI ELEMENT STILISTIK NË VEPRAT E DY AUTORËVE,
PËRFAQËSUES TË PERIUDHAVE LETRARE, FRASHËRI DHE KADAREJA**

Luljeta ADILI-ÇELIKU

Universiteti i Evropës Juglindore, Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit

l.adili@seeu.edu.mk

UDC 821.18:81'38

Professional paper

Abstract

Stylistics is a linguistic discipline that spread across Europe as a new derivation of linguistics and in later years of the twentieth century it spread all over the world. The stylistics of the Albanian language, as those of other languages, studies the means and possibilities of expression in Albanian, including the discourse styles as well as Albanian texts from the viewpoint of the secondary linguistic organization. This study has brought together the most renowned authors in Albanian literature, the representatives of two different literary periods, Naim Frasheri as a romanticist and Ismail Kadare, as a real modern literary representative.

Even though they (have) lived in different literary periods and they never had the chance to meet in person with one another, Kadare met the former's works – the stylistic element does not differ from each other. They used almost the same affixes for stylistic connotation of the words that they used. We can find in both works affixes that express meanings of diminutive or endearment, irony and mockery, etc. The specialty of such creations with diminutive affixes *-ëz*, *-th*, *-uc* is the fact that one can relate with them different nouns by creating words with concrete meaning such as *letërz*, *bisedëz*, *kartonth*, *zeth*, as well as *shtetth*, *sekretth*, *planetth*, *atëzë*, *këtëze*, etc.

The aim of using stylistic elements or *stylemes* has not always been the same in both of them. Frasheri used them more often for emotional connotation, in order to describe or say the verse more beautifully, or even express some doze of irony for something; on the other hand, in Kadare's creations we can find these elements used to mock or express irony. In addition, the aim of using these elements in the works of these authors was/has been the cleansing and enriching of the language itself.

Key words: *Affixation, stylistics, styleme, Naim, Kadare.*

Përmbledhje

Stilistika është disiplinë gjuhësore që u përhap në Evropë si një degëzim i ri i gjuhësisë dhe në vitet e mëvonshme të shekullit të njëzet u përhap në të gjithë botën. Stilistika e gjuhës shqipe, si ajo e çdo gjuhe tjetër, studion mjetet e mundësitë shprehëse të shqipes, sistemin e stileve të ligjërimeve dhe tekstet shqipe nga pikëpamja e organizimit gjuhësor dytësor. Ky studim „ka bërë në një vend,, dy autorët më me zë të lerave shqipe, përfaqësuesit e periudhave letrare, Naim Frashërin si romantik dhe Ismail Kadaren një modern i vërtetë letrar.

Edhe pse kanë jetuar në kohë të ndryshme, përfaqësojnë periudha të ndryshme letrare, nuk u takuan me njeri-tjetrin fizikisht, Kadareja e takoj vepren e të parit, elementi stilistik nuk dallon nga njëri-tjetri. Ata përdorën pothuajse të njëjtat ndajshtesa për ngjyrimet stilistike të fjalëve që krijuan. Edhe te Naimi edhe te Kadare i gjejmë ndajshtesat që shprehin kuptime zvogëlimi ose përkedheljeje, ironizimi e përqeshjeje etj. E veçanta e krijimeve të tilla me prapashtesat zvogëluese -ëz, -th, -uc, është fakti se bashkon me të emra të ndryshëm duke krijuar vërtet fjalë me kuptim konkret si: letërz, bisedëz, kartonth, zeth etj; megjithatë krijime të tilla si shtetth, sekretth, planetth, atëzë, këtëze etj.

Qëllimi i përdorimit të elementeve stilistike ose përdorimet e stilemave nuk janë çdoherë si njësitë të njëri dhe të tjetri, Frashëri më tepër i përdor thjeshtë për ngjyrimet emocionale, që më bukur të thuhet e përshkruhet vargu, si romantik që është, për të ironizuar dikë ose dicka; ndërsa te Kadareja i gjejmë më tepër për të ironizuar dhe përqeshur. Përveç kësaj, të dy qëllimi i përdorimit të këtyre elementeve është gjuhëpastrimi dhe gjuhëpasurimi.

Fjalët kyçe: *Ndajshtesimi, stilistika, stilema, Naim, Kadare.*

Hyrje

Në analizën tonë më poshtë do të rrekemi të japim edhe ngjyrimet subjektive të vetë fjalëve të cilat lindin nga marrëdhëniet vetjake të ligjëruesit me objektin e bashkëbiseduesin, nëse ka një të tillë. Dëshirat, emocionet, vullneti, vlerësimet e qëndrimet e atij që shkruan ose flet lënë gjurmë në stilemat që përdor. Nga studimet e Xhevat Lloshit për stilistikën e gjuhës shqipe, del se pikëvështrimi është në thelb psikologjik, subjektiv, ndërsa ngjyrimet janë: a) emocionale; b) të dëshirave të vullnetit; c) të vlerësimit e qëndrimit vetjak. Këtu duhet të thuhet se në krijimin e fjalëve të reja dhe në veshjen stilistike të tyre, autorët në fjalë përdorin

të gjithë arsenalin e gjuhës shqipe, në të gjitha nivelet stilistike të tij, duke u nisur nga vetë elementet fjalëformuese të cilat automatikisht fjalës i japin një ngjyrim stilistik, për të vazhduar me krijimin e fjalëve të cilat janë stilema nga cilido pikëvështrim: fonetik, leksikor ose semantik.

Parashtesimi si element stilistik

Parashtesat janë një nga elementet që autorët përdorin për krijimin e fjalëve, për pastrimin dhe pasurimi e gjuhës, si dhe për qëllime stilistike. Në këtë model fjalëformimi hyjnë fjalët me parashtesën, ç-/sh-/zh- dhe fjalë që i gjejmë te Kadareja si: çëndërr, çgaforrizim, çgjuhë, çjetë, çnjeri, çvalle; shkokë, shprijs; zhkomplot etj., te Naimi si : çkarkoj; çqyej, çfaq; çkëmbej, çquaj, çnderoj, çbrenjos. Në shikim të parë këta neologjizma janë krijime librore, poetike. Ndoshta nuk do ta tepronim po të thoshim se në krijime të tilla Kadarenë e shohim si një piktor surrealist dhe ndonjëherë impresionist, i cili duke shtuar qoftë edhe një parashtesë mund të japë nuanca ngjyrë, pamje, ndjenja që nuk ka mundur t'i shprehë askush.

Në këtë rast është ç-ja, ky tingull që ka një zvarritje brenda teksa shqiptohet, që ndrydh një rrënoqethje, një pabesi, një mbrapshtësi, ngjall te bashkëbiseduesi dhe te lexuesi ndjenjën e diçkaje të panatyshme dhe të mbrapshtë, ndërsa e njejta parashtesë te Naimi përdoret për thënë të kundërtën e fjalës së parme edhe si variant dialektor, d.m.th më tepër e përdor për qëllim gjuhëpasurimi duke sjellë gjuhën e të folmes së vetë shkrimtarit, nuk kemi ngjyrim stilistike si te Kadareja.

Prapashtesimi si element stilistik

Një përftesë tjetër me fjalëforimin tek e cila përzihen më shumë elemente stilistike është prapashtesa –shëm, aq dendur e përdorur nga Kadareja për të krijuar jo vetëm mbiemra të nyjshëm, por edhe një numër të madh ndajfoljesh. Një numër i tyre krijohen thjesht me çnyjzimin e mbiemrit të nyjshëm përkatës, mirëpo disa prej tyre janë krijime të reja. Njëfjalëzimi i lokucioneve ndajfoljore është veçori dalluese pothuajse vetjake e Kadaresë.

Nën shembullim e ndajfoljeve me –shëm që janë një dukuri e zakonshme e dialektit verior, Kadareja ka sjellë në jetë me dhjetëra ndajfolje të këtilla, duke zëvendësuar një numër të madh togjesh ndajfoljore. Kështu, duke pasur ndajfoljet e gegërishtes si gjedhe, te Kadareja mund të gjejmë ndajfolje të tilla si: ankthshëm, dehshëm, flladitshëm, habitshëm, humnershëm, mallëngjyeshëm etj. Duke iu shmangur qëllimisht togjeve ndajfoljore, Kadareja shkruan mundimshëm në vend të me mundim; përbuzshëm në vend të me përbuzje etj. Një

numër i tillë janë ndajfolje poetizma si: skëtërrshëm, trëndafilshëm, vetmueshëm, verbueshëm etj., të cilat që larg njihen se janë krijime të Kadaresë.

Është e udhës ta themi këtu se këto krijime ndajfoljore janë nuanca kryesore dhe elementi kryesor stilistik i ndajfoljeve të Kadaresë. Ashtu si te Kadareja edhe te Naimi e gjejmë përftesën stilistike –*shëm*, duke e kombinuar edhe me variantin me prejardhjen dialektore të kësaj prapashtese me fjalë të zakonshme, p.sh. *i/e panderçim-* varianti dialektor i prapashtesës. Naimi ka futur në gjuhën shqipe fjalë poetizma që në të njejtën kohë hapin rrugë për krijime të tjera të reja p.sh. *i/e qi/jellsh/ëm(e)*, *i/e friksh/ëm-* tek-tuk na del me variantin dialektor *frikshim i/e frikshim*, *i/e dëmtim*, *i/e përzish/ëm(e)*, *i/e përjetsh/ëm(e)*, *i/e gjithmenjëhersh/ëm(e)*, *i/e bëshëm*, *i/e gjithnjëshme* etj.

Të frikshim e të paqënë Parajsa fq. 30

Jashtë vëmendjes së Naimit dhe Kadaresë nuk mund të mbetnin aspak edhe prapashtesat tjera, siç janë ato që shprehin kuptime zvogëlimi ose përkedheljeje. E veçanta e krijimive të reja me prapashtesat zvogëluese –*ëz*, *-th*, *-uc*, është fakti se Kadareja bashkon me të emra të ndryshëm duke krijuar vërtet fjalë me kuptim konkret si: *letërz*, *bisedëz*, *kartonth*, *zeth* etj. njejtë është edhe te Naimi si: *gojëzë*; *bimëz*; *fluturëz*; *këngëz*; *qytezë*; *vijëz*; *folezë*; *pushkëz*; *gunëz*; *kunëz*; *gropëz*; *shkollëz*; *zemërzëz*; *thembërz*; *vashëz*; *shkronjëz*; *pasqyrëz*; *qipëz*; *kodërz*; *sheqëz*; *kronjëz*; *napëz*; *lundërzëz*; *qipallëz*; *klithmëz*; *hapëz*; *vatërzëz*; *ditëz*; *gjëzë*; *nënëz*; *punëz*; *gjuhëz*; *dritëz rezë*, *plaçkëz*, *dorëz*, *këmbëz*, *foshnjëz*, *jetëz*, *mëmëz*, *kuvlizë*, *shqezë*, *kafshëz*; megjithatë krijime me prapashtesën –*th* te Kadareja, si: *shtetth*, *sekretth*, *planetth* nuk mund të mos shihen si krijime me funksione artistike, ose akoma më thellë, me funksion poetik.

Ka emra të tillë të rinj si *shtetth* ose *planetth* një dhembshuri dhe një keqardhje që zakonisht shprehet për sende të vogla dhe të brishta, vetem se në këtë rast, siç vërehet, fjalët *shtetth* dhe *planetth* janë sende të mëdha që nuk rrezatojnë asnjë lloj ndjenje, e aq me pak dhembshuri, madje, lirisht mund të themi se në këtë rast Kadareja kësaj prapashtese i vesh petkun e ironisë, gjë të cilën nuk e ka pasur deri tani. E veçanta e gjuhës së Naimit, ose e pazakonshmja është bashkimi i –*th-së* me si një emër në numrin njëjës, ashtu edhe me një emër në numrin shumës.

Krahasuar me Kadaren, ky i dyti përftesë –*th* e përdor për ngjyrimet stilistike, për zvogëim e për përgdhelje, për t'i bërë sendet më të dashura dhe me të bukura si : *vëllath*, *shith*, *zëth*, *gjith*, *trëndafilth*, *lumth*, *plakth*, *florith*, *lotth*, *vëndth*, *thëngëlith*, *gasth*, *djalëth*, *krahëth*, *shtrath*, *zott*, *syth*, *vajtith*. Lirisht mund të themi se krijimet e Naimit me këtë prapashtesë ngelen unike në letrat shqipe, të papërsëritshme dhe të përjetshme. Një grup tjetër

fjalësh të reja që diktohen që larg se janë të Kadaresë janë emrat e rinj të krijuar me parashitesën –ëri.

Duke e përdorur këtë prapashtesë në njërën anë Kadareja ka krijura fjalë të reja duke iu shmangur kështu ndonjë fjale të huaj si trupëri në vend të fizikalitet ose edhe të ndonjë fjale tjetër. Kjo prapashtesë, e cila zakonisht tregon një gjendje ose një karakter ka gjetur shprehje në fjalë të tilla si: gomarëri, matufëri, ngulmëri, pushtëri, tuhafëri etj. Por, një grup fjalësh janë më afër funksionit artistik dhe stilistik. Fjalë të tilla poetike si: gurëri, jetimëri, korbëri, lotëri, qelqëri, më shumë se sa me prapashtesën vetë, lidhen me organizimin tingullor, madje edhe me vetë grafematikën e këtyre fjalëve të cilat ë-ja ashtu edhe i-ja mbi to ngjallin përshtypjen e shumësisë.

Ngjyrimet stilistike me përftesën –ëri janë të pranishme edhe te Naimi. Këtë prapashtesë ai e përdor për të zbukuruar apo ironizuar gjendjen apo karakterin e ndonjë personi, si kurvëri, trimëri, qytetëri, madhëri, marrëzi, zotëri etj. Por nuk mungojnë edhe krijimet rastësore të kësaj natyre me karakter poetik si : djalëri, vajzëri, fjalëri, pleqëri, foshnjëri, mbretëri etj. Gjuhës së Naimit i shkojnë përdore krijime të tilla, stilit të letrave të tij. Në fushë stilistikës nuk mund të mos e përmendim përdorim e gjerë të emrave prejfoljore me –im. Në stilin e një skulptori autorët i latojnë me shumë kënaqësi fjalët me këto dy prapashtesa.

Këta emra, duke zënë vendin e foljes drejtpërdrejtë iu japin thënieve një kuptim tjetër. Edhe në fushë të semantikës këta emra sjellin të reja, ashtu si e kemi thënë më lart. E veçanta është kuptimi i ri që marrin, si: thellim, burim, dëftim, mejtim, lakmim, mburrim, mallkim, rrëmbim, lëvdim, shëmtim, mallëngjim, pushim, hidhërim, zemërim, bashkim, mundim, gjëmim, mallëngjim, gëzim, mendim, qëndrim, shtrëngim, rrëmbim, mundim, pushim.

Një pjesë e tyre mbeten me kuptimin e emrit prejfoljor të veprimit, ndërsa ka një numër që vetëm Kadareja i përdor për të dhënë kuptime konkrete si p.sh.: dritëzim, gjithësim, lakuriqësim, shpellim, urdhërim e të tjera. Ky është pra stili i Kadaresë: kthimi i disa emrave të cilët morfologjikisht mund të ishin emra abstraktë dhe të veprimit, ndërsa shkrimtari i kthen ata në një kategori tjetër, diçka midis abstraktes dhe konkretes, midis reales dhe joreales.

Kompozimi stilistik

Kur vjen fjala për kompozitat e Kadaresë, duhet ta themi se janë të shumta, përfshirë këtu kompozitat e kategorive të ndryshme leksiko-gramatikore. Disa janë krijime rastësore me ngjyrimë therëse si p.sh.: bejtethurës, çfinafutës, dhelperdashje, prejardhoman etj. që mbërthejnë një ironi brenda vetes. Ka edhe të tillë që japin kuptime abstrakte dhe surrealistë, të pakapshme, ndonëse pjesët përbërëse të tyre janë emra të zakonshëm.

Kështu fjalë të tilla: dehashpirt, dyvejushë, dyzanafillë, drekë-makth, fundbota, hyjanjeri, mortajets, pragmuzg, vdekjejetë, i vdekjejetshëm. Kompozitat e Kadaresë janë shtylla tjetër kryesore e fjalëkrijimit të tij. Njëfjalëzimi i një pjese të leksikut të shqipes, ngjashëm me të gjermanishtes për të cilën Kadareja ka një respekt të veçantë, është ndoshta krejt lajtmotivi i fjalëve të reja të këtij shkrimtari. Duke i dhënë gjuhës sonë një tufë të madhe fjalësh të veçantë, Kadareja tërthorazi tregon besimin dhe bindjen se shqipja është një gjuhë e eprshme, e gjallë, e cila, ndonëse jeton në kohë moderne dinamike dhe të rrezikshme, vazhdon të mbetet gjuha që munda t'u bëjë ballë sundimeve të gjuhëve të tjera në kohëra të mëparshme.

Për të pasur një veshtrim të shkurtër për disa nga veçoritë stilistike të fjalëve të Naimit do të ishte e mangët nëse nuk do përmendnim një nga qokat e krijimtarisë gjuhësore të tij, pra kompozitat e larmishme të veprës së tij. Naimi e ka shtuar ndjeshëm numrin e kompozitave dhe qëllimi i tyre e kalon në disa raste atë stilistik, ai krijoji shumë fjalë të reja me qëllim gjuhëpastrimi, ishte dhe një nga misionet jetësore të tij, si : dheshkronjë, abceshkronje, mëmëdhe etj. Edhe te Naimi sikurse te Kadare gjejmë kategori te ndryshme kompozitash.

Ka nga ato me kuptime abstrakte: fatzi, shpirtmadh(e), zemërgjerë, vetëdija, zemërshtig(ë), veshflorinjte , zemër-gur , këmbergjendte etj., krijime rastësore te poetika, si: punëmbarë, syzezë, bukëvale apo të tilla që ngërthejnë ironi: kokëthatë, vesh-gjatë, brigjatë, zëtrashë etj. Në një kategori hyjnë kompozitat flori-punonjës, ergjent-punonjës, symëshqerrër, sy-shkëndijë udhërrëfenjës, gënjeshtër-madh(e), fat-mirë, gjak-ngjirë, buzë-embël, faqezi/zezë, vrapmadh(e), jetë-gjatë, sisëbardhë, jetëgjatë, zemërlig(ë), faqe-bardhë , kokunjur; mes-hollë.

Këmbergjentë veshflorinjte

Ish si zonja *sisëbardhë*,

Lumënj *vrapmëdhenj* pa gjumë. Parajsa fq.292-293

Përfundimi

Stilistika si disiplinë gjuhësore vonë erdhi në letrat shqipe, pas jetës së Naimit, por te ky autor elementet stilistike janë pothuajse aq të pranishme sa tek Kadareja. Meqë u takojnë periudhave te ndryshme letrare, sigurisht që temat dhe motivet e veprave të tyre janë të ndryshme, ndryshe ishte koha dhe rrethanat kur veproi Naimi, e ndryshe kur ende vepron Kadareja, por ajo që mbetet e përbashkët është së përfesat stilistike si në sasi ashtu dhe në cilësi përdoren njëjtë te të dy.

Siç shihet edhe nga punimi më lart, Kadareja shkon në një shkallë më të lart të ironizimit dhe përqeshjes së situatave e personazheve dhe këtë e bën si një mjeshtrë i vërtetë, pa mos iu përmbajt ligjeve të shqipes dhe pa mos i prishur ata.

Bibliografia

Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I*. Tiranë, 1995

Lloshi, Xhevat. *Stilistika dhe pragmatika*. Tiranë: Toena, 1999

Kadare, Ismail. *Spiritus*. Tiranë: Onufri, 1996, 2003.

Kadare, Ismail. *Kushëriri i engjëjve*. Tiranë: Onufri, 1997

Kadare, Ismail. *Pasardhësi*. Tiranë: Onufri, 2003

Kadare, Ismail. *Kështjella*. Tiranë: Onufri, 2003.

Sotiri, Natasha. *Fjalori i gjuhës së Ismail Kadaresë*. Tiranë: Medaur, 2007 .

Thomai, Jani. *Leksikologjia e gjuhës shqipe*. Tiranë: Botimet Dudaj, 2005.